



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3754 prot.

Fushë-Arrëz, më 27.11.2025

PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 27.11.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Bardhok Qafa; Besjana Marku; Lin Prendi; Mustaf Pashkaj; Valentina Lleshaj; Tereze Dema, Zef Cara**

(8 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Në mbledhje merr pjesë për një interval kohor Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri**.

Gjithashtu ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **Specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas agjendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **Z. Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Nëntor 2025! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Pjesëmarrja plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Përpara se të miratojmë rendin e ditës po ju bëj me dije se Kryetari i Bashkisë ka një kërkesë për shtim të një pike në rendin e ditës: "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e **Z.Sadri Dervishi** lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi "Emergjencat Civile"

Kërkohet dakordësia me votë për shtimin e pikës së kërkuar në rendin e ditës nga Kryetari i Bashkisë.

- Miratohet me vota të të gjithë këshilltarëve pjesëmarrës shtimi në rend të ditës i pikës për "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e **Z.Sadri Dervishi** lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi "Emergjencat Civile"

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 27.11.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 29.10.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Tetor 2025.
4. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
5. Pikë e shtuar: Projektvendim për Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagja Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi “Emergjencat Civile”.
6. Të ndryshme.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.11.2025.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës me pikën e shtuar përmes votimit:

- Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 29.10.2025.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak: Procesverbali mban gjithçka lidhur me mbledhjen e muajit Tetor 2025. Këshilltarët e kanë në dosjet e tyre secili, gjithashtu procesverbali është hedhur në ëeb-in zyrtar të Bashkisë (Këshilli Bashkiak) menjëherë mbasi është zbardhur. Nëse keni diçka për të thënë, mundeni.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 29.10.2025.

- Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 29.10.2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Tetor 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Klotilda Curri, Përgjegjëse në Sektorin e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se për muajin Tetor 2025 përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës prej 6%, 26 familje, me fond 104,504 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,741,740 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën 104,376 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz, 12 familje me fond 39,650lekë.
2. Njësia Administrative Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë.
3. Njësia Administrative Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Administrative Fierzë , 3 familje me fond 19,424 leke .
5. Njesia Administrative Iballe , 4 familje me fond 16,990 lekë .

Znj. Curri thekson se në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndihmë Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë të varfra ku bazohemi edhe te VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6% , është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë, të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

Klotilda Curri, Përgjegjëse në Sektorin e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se trajtohen me ndihmën ekonomike 6% të gjitha familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, Dave Pal Alija, Dile Ndue Gjoni, File Fran Lleshi, Fran Zef Mhilli, Gzim Marash Hajdari, Katrina Zef Zmalaj, Ndoc Kol Prendi, Zekije Isa Hyseni. Gjithashtu shtohen në bllok ndihmën e 6% familja e Dile Gjoni dhe largohen nga bllok-ndihma prej 6% familjet, Rexhep Hasanaj dhe Katrine Prendi.

Tereze Dema, anëtare e komisionit, jemi dakord me propozimet e bëra për familjet përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i bllok ndihmës prej 6 %. Duhet të ndihmohen edhe familje të tjera në nevojë për aplikim dhe të përfitojnë sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Tetor 2025 përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Tetor 2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Kërkesa e parë, drejtuar me shkrim Këshillit Bashkiak thotë: “Mbeshtetur ne Ligjin 139/2015 per Veteqeverisjen vendore ne nenet 19,20 dhe 23 te ketij ligji ne banoret e fshatit Berishe e Vogel lagjia Brebull te Njesise Administrative Iballe kerkojme nga keshilli bashkiak

Fushe-Arrez miratimin dhe dhenjen e lejes per ndertimin e nje rruge auto me gjatesi rreth dy km nga rruga e lagjes Majsa fshati Berishe e Eper per ne Brebulla(Belshina). Kjo rruge ju sherben banoreve te zones per lehtesimin e kushteve te jeteses dhe zhvillimin e zones. Financimi i kesaj rruge do te behet nga vete baoret e lagjes Brebulla. Kemi besim se kerkesa jone do te merret parasysh nga ana juaj”.

Këshilli Bashkiak, përmes Sekretares së këshillit, Naze Selimaj i ka përcjellë këtë kërkesë, Zyrës së posaçme (Urbanistike) për shqyrtim të detajuar brenda kornizave ligjore në fuqi.

Zyra Urbanistike lidhur me kërkesën ka kthyer këtë përgjigje me shkrim:

“Bazuar ne ligjin Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", VKM Nr 408 date 13.05.2015 "Per Miratimin e Regullores se Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit", si dhe ne perigiigje te shkreses tuaj te protokolluar ne Bashkine Fushe-Arrez me Nr 3657 date 18.11.2025, ju sqarojme si me poshte:

1-Sipas kerkeses se banoreve te fshatit Berishe e Eper Lagjia Majsa) , kerkohet hapja e nje rruge auto te re me gjatesi 2km, por pa percaktuar intinerarin e saj dhe gjurma nga ku do te kalohet.

2- Sipas legjislacionit ne fugi zhvillimi i ketij lloji projekti kerkon projekt -zbatimi te plote dhe relacione teknike dhe mjedisore shoqeruese, mbi bazen e te cilave miratohet leja e ndertimit pavaresisht kush eshte financuesi i tij.

3-Plotesimi i dokumentacioneve fillon me konsultimin publik me banoret perfitues dhe impaktin qe ky objekt ka ne territor dhe me pas hartimi i projektit te zbatimit nga projektues te licensuar.

4-Meqenese objekti eshte per interes publik perjashtohet nga tarifat perkatese.

Ju falenderojme per bashkepunimin! Konceptoi, Ing. Tonin Prenga”.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ne si Këshill Bashkiak, ia kemi përcjellë kërkesën Drejtorisë së Urbanistikës në bashki për shqyrtim të detajuar bazuar në kornizën ligjore në fuqi. Ne si këshill sugjerojmë administratës së bashkisë të bëjë një projekt teknik të përgjithshëm ku të vlerësohen financat dhe më pas kërkohet bashkëpunim mes banorëve dhe bashkisë përmes dëgjësës publike.

Tereze Dema anëtare e këshillit bashkiak, banore e Njesisë Iballe: Kjo kërkesë duhet studiuar me vëmendje, duhet të verifikohet sepse mund të ketë edhe kontradikta mes banorëve.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Banorët atje po kërkojnë mbështetje me dokumentacion ligjor. Këshilli Bashkiak është i hapur dhe i gatshëm të miratojë çdo akt brenda kornizës ligjore mbasi administra e bashkisë ka kaluar të gjitha procedurat ligjore.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Kërkesa e dytë, drejtuar me shkrim Këshillit Bashkiak thotë: “ Unë i quajturi Pavlin Ndrec Qafa, banues i Qytetit Fushë-Arrëz, i drejtohem Kryetarit të Bashkisë dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak që të merret parasysh kërkesa ime si më poshtë: Kërkoj të vendosen ndalesa në unazën e poshtme të qytetit pasi më rrezikohet jeta e familjes nga lëvizja me shpejtësi të makinave qoftë të vogla dhe të mëdha. Me respekt, Pavlin Qafa”.

Këshilli Bashkiak, përmes Sekretares së këshillit, Naze Selimaj i ka përcjellë kërkesën Zyrës së posaçme (Urbanistike) për shqyrtim të detajuar brenda kornizave ligjore në fuqi.

Nga Zyra e Urbanistikës kemi këtë përgjigje me shkrim:

“Bazuar në ligjin Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr 107/2014 "Për Planifikimin e Territorit", Ligjin Nr 8378 date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", Vkm Nr 408 date 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit", si dhe ne përgjigje

te shkreses tuaj te protokolluar ne Bashkine Fushe-Arrez me Nr 3698 date 21.11.2025, ju sqarojme si me poshte:

1-Segmenti rugor Unaza e Qytetit eshte pjese e Aksit Nacional Kombetar Tirane

-Fushe-Arrez -Kukes dhe sipas PPK-se eshte rruge terciare ne pronesi dhe administrim te ARRSH-se.

2- Sipas legjislacionit ne fuqi, çdo punim, nderhyrje apo gjithçka qe lidhet me kete rruge duhet te marre me pare miratimin e ARRSH-se. Ju falenderojme per bashkepunimin!

Drejtoria e Planifikimit Kontrollit Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve, Tonin Prenga”.

Hil Curri, Kryetar i bashkisë: Ne duhet të bëjmë një kërkesë ARRSH-së për procedurat e ngritjes së ndalesave të tilla aty dhe te Gjimnazi, gjithmonë në përputhje me aktet ligjore dhe më pas të vihet te vendimi i këshillit.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Segmenti rrugor te Gjimnazi i përket Bashkisë, ndërsa unaza është aks i rrugës nacionale.

Unë jam për zgjidhje me trotuare, jo me atë ndalesën (bum) . E mira duhej të ishte me semaforë në kryqëzim. Ne si këshill, bashkohemi me shqetësimin e kërkuarit sepse realisht është problem shqetësues për familjen në fjalë.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Pikë e shtuar: “Projektvendim për Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagja Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi “Emergjencat Civile”.

Dod Pepa, Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:

Me datën 14.11.2025 është djegë banesa e familjes së Sadri Dervishi lagja Trun i Poshtëm fshati Sakat Njësia Administrative Blerim me 10 anëtar dhe dy kurorë (familje) . Bashkia me të marrë informacionin ka bërë ngritjen e grupit të punës për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, ku pas konstatimit të dëmit janë bërë verifikimet përkatëse duke u shënuar të gjitha në procesverbalet e konstatimit dhe më pas duke hartuar preventivin e dëmit nga ana strukturore (ndërtimore) në vlerën prej 2 452 713 lekë dhe preventivin e mobiljeve në vlerën 310 500 lekë me vlerë totale dëmi 2 763 213 lekë, ku sipas VKM-së Nr. 329 date 16.05.2012 pika 3 paragrafi ç, masa e ndihmës financiare do të jetë 50% e vlerës së dëmit të përlogaritur dhe konkretisht 1 381 606 lekë.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, në ligjin Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 8756 datë 23.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret

dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kreu III¹, si dhe në Vërtetimin e lëshuar nga MNZ Fushë-Arrëz me datë 21.11.2025 mbi djegien e banesës së shtetasit **Sadri Dervishi**, Sektori i Emergjencave Civile, Financës dhe Kryetari i Bashkisë i propozojnë këshillit bashkiak:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetjen financiare të shtetasit Sadri Dervishi për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025 me vlerë dëmsh të preventivit strukturor në vlerën e 2 452 713 lekë dhe preventivit të mobiljeve në vlerë 310500 lekë me vlerë totale demt 2 763 213 lekë.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Fushë-Arrëz për familjet e dëmtuara .
3. T’i akordojë familjes së shtetasit Z. Sadri Dervishi lagja Trun i Poshtëm, fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, ndihmën emergjente në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë nga buxheti i bashkisë Fushë-Arrëz, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga këshilli i bashkisë për vitin 2025.
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Sadri Dervishi, të përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 dhe ligjin Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” Për shpërblimin e dëmit të përdoret fondi i Emergjencave Civile i cili sistemohet në paksim nga Gr.00, Tit 03280, Kap 01, Art 609.1009 dhe në shtesë Gr.00, Tit 03280, 606 0099.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjeve të sipërcituara, banesa e të cilëve është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025. Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagja Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi “Emergjencat Civile”, sipas dokumentacionit të dorëzuar në sekretarinë e Këshillit Bashkiak:

- Miratohet Projektvendimi për Miratimin kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagja Trun i poshtëm, fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, program “Emergjencat Civile” me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 6 e rendit të ditës: Të ndryshme. (S’ka diskutime)

Të nderuar këshilltarë unë ju falenderoj që ishit present sot dhe mundësuat miratimin e Vendimeve të sotme, sidomos atë të 6%-shit të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë.


Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Tereze Demir
Valentina Hleshaj
Lil' Prenoli
Bardhok Dajç
Mustaf Vahidaj
Zef Cerri

Jamuz
Dajç
Gjiri
Dajç
Gjiri
Gjiri



Fushë-Arrëz, më 27.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT NË
MBLEDHJEN E KËSHILLIT BASHKIAK TË DATËS 27.11.2025

Nr.	Emër	Mbiemër	Nr. telefoni & whatsApp (nëse ka ndryshuar)	Firma
1.	Besjona	Morku	—	Besjona
2.	Valentina	Lleshaj	—	Valentina
3.	Tekez	Demir	—	Tekez
4.	Ilir	Renolli	—	Ilir
5.	Bayol	Qefi	—	Bayol
6.	Nijati	Sabri	—	Nijati
7.	Mustaf	Tashiri	—	Mustaf
8.	Zef	Leke	—	Zef
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				